

LEKTORIUM
ETNONIMI SHQIPTAR - SHFAQJA DHE SHNDËRRIMET E TIJ
FUNKSIONALE DERI NË SHEK. XVIII
– NGA PROF.. DR. BARDHYL DEMIRAJ

Në kuadrin e lektoriumeve të institucionalizuara tashmë në Institutin e Gjuhësisë e të Letërsisë, në datën 3 tetor 2022 prof. dr. Bardhyl Demiraj, ish punonjës i IGJL-së dhe sot drejtues i Qendrës Albanologjike pranë universitetit Ludwig-Maximilian të Mynihut, mbajti një ligjëratë me temë “Etnonimi SHQIPTAR - shfaqja dhe shndërrimet e tij funksionale deri në shek. XVIII”.

Ligjëratata pasqyroi rezultatet e studimeve të tij afatgjata të natyrës ndërdisiplinore mbi etnonimin “shqiptar”, studime që përfshijnë aspekte të ndryshme historike, gjuhësore, etimologjike, filologjike, gjeografiko-dialektore, kulturore-fetare e sociologjike të përdorimit të këtij emri etnik në popullsinë shqipfolëse. Autori përpiqet të shpjegojë edhe arsyet e përgjithësimit të këtij emri etnik në bazë të një studimi sociologjik të emrave të ndryshëm etnikë që dalin te Kuvendi i Arbënit, 1703. Në ligjëratë u sollën edhe të dhënat e zbulimeve të fundit mbi daljen e këtij emri në mes të shek. XVII, në bazë të gjetjeve të një dokumenti të rëndësishëm për historinë fetare e kulturore të Shqipërisë së Veriut në shek. XVII nga gjurmuesi i arkivave Mark Palnikaj. Ky dokument përmban edhe një fjali shqip në të cilën gjendet emri “shqiptar” i përdorur me kuptimin “ai që njeh gjuhën shqipe”, pra “shqipfolës” pavarësisht nga etnia dhe besimi fetar. Dalja e këtij emri që në vitin 1639 e avancon me mbi 60 vjet atë që njohim deri tani si shfaqjen për herë të parë në dëshmi shkrimore të emrit “shqiptar” (1702 nga da Lecce).

Në ndërhyrjen e saj, prof. Anila Omari vuri në dukje hulumtimet dhe zbulimet e fundit të prof. Lucia Nadin në arkivin e françeskanëve të Venecias, ku fjalia shqip rezultoi e shkruar në fillim nga ati françeskan Cherubino da Trento i cili e njihte më së miri gjuhën shqipe. Nisur nga kjo e dhënë, ajo theksoi rëndësinë e konsultimit të origjinalit në punën filologjike me tekstin.

Ligjëratata u ndoq me interes nga punonjës të IGJL-së dhe të ftuar nga Departamenti i Gjuhësisë i Fakultetit të Filologjisë të UT-së, si dhe virtualisht nga pjesëmarrës të jashtëm.

